



**Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court**

Prishtinë, 13 maj 2010
Nr.ref.:RK 40/10

VENDIM PËR PAPRANUSHMËRI

në

Rasti nr KI 37/09

Parashtruesi i kërkesës X

kundër

Vendimit të Senatit të Universiteti i Prishtinës dt. 29/09.2009

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Cukalovic, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare
Iliriana Islami, gjyqtare

Njëzëri miraton Vendimin mbi papranueshmërine, që ka të bëjë me kërkesën.

Kryetari i Gjykatës Dr. Enver Hasani në përputhje me nenin 18 par.1 pika 1.3 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës(Ligji nr 03/L -121) ka deklaruar konfliktin e interesit dhe ka kërkuar përjashtimin e tij përgjatë tërë procedurës së shqyrtimit të këtij rasti dhe pasi që kërkesa e tij është aprovuar nga gjyqtarët ,kryetari nuk mori pjesë në asnjë nga fazat e shqyrtimit dhe të procesit të vendimarrjes për këtë lëndë.

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është banor i Republikës së Kosovës.

Vendimet e kundërshtuara

2. Parashtruesi i kërkesës sfidon Vendimin e Senatit të Universitetit të Prishtinës të datës 29.09.2008 me të cilën i është refuzuar ankesa lidhur me vendimin për zgjedhjen e kandidatit sipas konkursit publik të dt. 07.03.2008 për pozitën e mësimdhënësit të lëndës ‘Kriminalistikë dhe Taktikë Kriminalistike’.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar janë shkelur: Parimet themelore të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të deklarates Universale për të Drejtat e Njeriut, parimet themelore të Kushtetutës së Kosovës dhe të Statutit të U.P-së.

Baza juridike

4. Neni 113 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (ne vijim si “Kushtetuta”); Neni 20 i Ligjit 03/L-121 mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (ne vijim si “Ligji”); dhe Neni 54 (b) i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (ne vijim si “Rregullorja e Punës”).

Përmbledhje e procedurës para Gjykatës

5. Parashtruesi i kërkesës, paraqiti kërkesën e tij pranë Gjykatës Kushtetuese me 11 shtator 2009. Ai kërkoi që në vendimin e kësaj Gjykate të mos i zbulohet identiteti dhe kërkesa e tij u aprovua.
6. Me 13 maj 2010, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kadri Kryeziu, Kolegji Shqyrtues, i përbërë nga gjyqtaret Iliriana Islami, Altay Suroy dhe Gjulijeta Mushkolaj, brenda të njëjtës dite i paraqiti rekomandimet e veta për të refuzuar lenden si të palejueshme para përbërjes së plote të Gjykatës.

Faktet

7. Me 29.10.2008 parashtruesi i kërkesës kishte pranuar vendimin ref. nr 2/593 dt. 6.10.2008 të lëshuar nga Senati i U.P me të cilin refuzohet ankesa e tij ushtruar këtij organi për moszgjidhjen e tij dhe zgjedhjen e një kandidati tjetër për pozitën e punës ‘mësimdhënësit për lëndët “Kriminalistike dhe Taktika Kriminalistike” sipas konkursit publik të publikuar në mjetet publike të informimit me 07.03.2008.
8. Me 21.11.2008 parashtruesi i kërkesës X i drejtohet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë – shërbimit të Inspektionit duke kërkuar anulimin e vendimeve si në pikën 7 të këtij vendimi dhe me të njëjtat arsyeime të Senatit të U.P-së të datës 29.09.2008 dhe të rezultateve të konkursit të U.P-së të dt. 07.03.2008 për Mësimdhënësit të lëndëve “Kriminalistike dhe Taktika Kriminalistike” duke i cilësuar ato si të “kundërligjshme, antishkencore, johumane dhe diskriminuese”.

9. Me 02.03.2009 parashtuesi i kërkesës i drejtohet Kryeministrit të Kosovës dhe Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, me kërkesë për anulimin e Vendimeve si në pinën 7 të këtij vendime me të njëjta arsye time.
10. Më 04.05.2009 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës me Vendimin A 02(48) 09, ishte shpallur jokompetent për të vendosur lidhur me ankesën e parashtuesit x lidhur me kontestimin e zgjedhjes së kandidatit sipas konkursit publik në U.P, duke u bazuar në nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/12 me të cilën është ndryshuar Rreg. 2001/36 për Shërbimin Civil në Kosovë, nenin 25 par. 25.5 të ligjit për Arsimin e Lartë (l.nr 202/03 i Kuvendit të R.K) dhe nenit 178 të Statutit të U.P-së.

Pretendimet e parashtuesit të kërkesës

11. Parashtuesi i kërkesës, në kërkesën e tij, pretendon se i është mohuar e drejta e punës, neni 49.1 i Kushtetutës, pa e shtjelluar çështjen me tej.

Vlerësimi për lejueshmërinë e kërkesës

12. Për të gjykuar për kërkesën e parashtuesit, Gjykata, së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtuesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuar në Kushtetutë. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet Nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike dhe të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

13. Neni 48 të Ligjit i cili përcakton:

"Parashtuesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtuesi dëshiron ta kontestoj."

14. Bazuar në dokumentacionin e paraqitur në lëndë Gjykata kartë konstaton se pas vendimit të marrë nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës (vendimi A 02(48)2009) parashtuesi i kërkesës nuk ka përdorur asnjë mjet tjetër juridik të ankimit edhe pse në udhëzimin Juridik të vendimit të KPMK-së qartazi është theksuar se vendimi i nënshtrohet "shqyrtimit gjyqësor në përputhje me ligjin".
15. Gjykata gjithashtu thekson me këtë rast se legjislacioni i brendshëm e sidomos Ligji për Procedurën Kontestimore (ligji Nr. 03/L-006 i Kuvendit të Republikës së Kosovës) parasheh kompetencën për kontestet nga Marrëdhënia e punës për Gjykatat e rregullta dhe siguron mjete efektive të ankimit për realizimin e të drejtave që supozohet se janë shkelur.
16. Për më tepër ky ligj në nenin 475 ka paraparë "Në kontestet nga marrëdhënia e punës, e sidomos me rastin e caktimit të afateve dhe konvokimit të seancave gjyqësore, gjykata gjithmonë do të ketë parasysh nevojën e zgjidhjes së ngutshme të kontesteve nga marrëdhënia e punës."
17. Duke marrë parasysh sa më sipër, Gjykata vlerëson se parashtuesi x në asnjë rast nuk i është drejtuar një Gjykate kompetente për vendim marrje lidhur me kërkesën të cilën e ka ngritur në Gjykatën Kushtetuese.

18. Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'ua ofrojë autoriteteve në fjale, përfshirë edhe gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi ligjor i Kosovës, do të sigurojë mjet efikas ligjor për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni v. France nr. 25803/94, Vendim i 28 korrikut 1999).
19. Gjykata përcakton gjithashtu, se thjeshtë një dyshim për sa i përket perspektivës së çështjes nuk është i mjaftueshëm për të përjashtuar një ankues nga detyrimi i tij për t'u ankuar në organet kompetente vendase (shih *Whiteside the United Kingdom*, vendimi i datës 7 mars 1994, kërkesa nr. 20357/92, DR 76, f.80).
20. Parashtruesi I kërkesës gjithashtu nuk e ka qartësuar kërkesën, nuk e ka arsyetuar atë as në aspektin procedural e as substancial në mënyrë që të dëshmonte se një e drejtë Kushtetuese i është cenuar.

PER KETO ARSYE

21. Gjykata, pas shqyrtimit të gjitha fakteve dhe dëshmive të ofruara, dhe pas shqyrtimit të çështjes me 13 maj 2010, përfundoi se parashtruesi i kërkesës NUK i ka shterur të gjitha mjetet ligjore në dispozicion dhe njëzëri

VENDOS

- I. TA HEDHE POSHTË kërkesën si të papranueshme.
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me Nenin 20.4 të Ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Mr. sc. Kadri Kryeziu, d.v.



Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese

Robert Carolan (sipas autorizimit) d.v.